

LIGJI NR. 04/L-250

PËR AGJENCINË E SHËRBIMET TË NAVIGACIONIT AJROR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË E SHËRBIMET TË NAVIGACIONIT AJROR

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është themelimi i Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror – ASHNA për të siguruar infrastrukturën dhe shërbimet e navigimit ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet për çdo avion që qarkullon në trafikun e përgjithshëm ajror në territorin dhe hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës ose hapësirën tjetër ajrore për të cilën Republika e Kosovës ka përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të kontrollit të navigacionit ajror.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **ASHNA** - Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës;

1.2. **Marrëveshja për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit** - Marrëveshjen shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (30 nëntor 2006), e cila është e detyrueshme për Republikën e Kosovës;

1.3. **Shërbimi i informimit aeronautik** - shërbimin e themeluar në kuadër të hapësirë së përkufizuar të mbulimit, i cili është përgjegjës për ofrimin e informatave aeronautike dhe të dhënave të nevojshme për sigurimin, sigurinë, rregullimin dhe efikasitetin e navigacionit ajror;

1.4. **Shërbimet e navigacionit ajror** - shërbimet e hapësirës ajrore të Kosovës ose cilësdo hapësirë tjetër ajrore për të cilën Kosova është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kontrollit të navigacionit ajror: (1) shërbimet e trafikut ajror, (2) komunikimet, (3) shërbimet e navigacionit dhe vëzhgimit, (4) shërbimet meteorologjike të navigacionit ajror, dhe (5) shërbimet e informimit aeronautik;

1.5. **Ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror (OSHNA)** - çdo subjekt publik ose privat, i certifikuar nga autoriteti kompetent, i cili ofron shërbime të navigacionit ajror për trafikun e përgjithshëm ajror;

1.6. **Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror (SHKTA)** - shërbimi i cili ofrohet për qëllime të:

1.6.1. parandalimit të përplasjes ndërmjet avionëve dhe në zonën e manovrimit të përplasjes ndërmjet avionëve dhe pengesave; dhe

1.6.2. përshpejtimit të qarkullimit dhe mbajtjes së rregullit në trafikun ajror.

- 1.7. **Shërbimet e trafikut ajror** - shërbimi e ndryshme për njoftimin e fluturimeve, shërbimet e paralajmërimit, shërbimet këshillimore të trafikut ajror dhe shërbimet KTA (shërbimet hapësinore, të ardhjes, dhe të kontrollit të aeroportit);
- 1.8. **Avion** - do të thotë çdo mjet që mund të gjenerojë mbështetje në atmosferë si pasojë e reaksioneve të ajrit, përveç reaksioneve të ajrit në sipërfaqen e tokës;
- 1.9. **Operator i avionit** - personi fizik ose juridik i cili operon ose propozon të operojë me një apo më shumë avion, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, me lizing ose përmes ndonjë aranzhimi tjetër;
- 1.10. **Aeroport** - hapësira e aterimit e cila shfrytëzohet rregullisht nga avionët për marrjen ose shkarkimin e udhëtarëve ose të ngarkesave;
- 1.11. **Anekset e Konventës së Çikagos** - dokumentet e nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ONAC) të cilat përmbajnë Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara që zbatohen në aviacionin civil;
- 1.12. **AAC** - Autoriteti e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës;
- 1.13. **Konventa e Çikagos** - korniza ndërkombëtare për marrëveshjet e aviacionit civil, e cila zyrtarisht njihet si Konventa e Aviacionit Ndërkombëtar Civil;
- 1.14. **Aviacion Civil** - operimi e çfarëdo avioni civil për qëllime të operimeve të aviacionit të përgjithshëm, punë ajrore ose operime të transportit ajror komercial;
- 1.15. **Certifikata** - dokumenti i cili lëshohet nga AAC-ja në pajtim me legjisllacionin e Republikës së Kosovës i cili konfirmon që një ofrues i shërbimit të navigacionit ajror i plotëson kushtet për ofrimin e një shërbimit specifik;
- 1.16. **Operimi i transportit ajror komercial** - operimi i avionit që përfshinë transportimin e pasagjerëve të ngarkesës ose postës përmes kompensimit, qirasë ose shpërblimit;
- 1.17. **Trafiku i përgjithshëm ajror** - të gjitha lëvizjet e avionëve civil, si dhe të gjitha lëvizjet e avionëve Shtetërorë, kur këto lëvizje zhvillohen në pajtim me procedurat e ONAC-ut dhe Ligjit për Aviacionin Civil;
- 1.18. **Aviacion i përgjithshëm** - një operim ajror civil i cili nuk është operim i transportit ajror komercial ose operim i punëve ajrore;
- 1.19. **ONAC** - Organizata Ndërkombëtare te Aviacionit Civil;
- 1.20. **Shërbimet meteorologjike** - pajimet dhe shërbimet të cilat iu ofrojnë avionëve parashikime meteorologjike, raporte, vëzhgime, informata dhe të dhëna të tjera meteorologjike për qëllime aeronautike;
- 1.21. **Navigimi i avionit** - funksioni i cili përfshin navigimin e avionit, dhe përfshin pilotimin e avionit;
- 1.22. **Shërbimet e navigacionit** - ato paisje dhe shërbime të cilat avionëve u sigurojnë informata rreth pozicionimit dhe përcaktimin e kohës;
- 1.23. **Person** - çdo person fizik, shoqëri tregtare, firmë, ortakëri, korporatë, kompani, shoqëri, shoqëri aksionare, asociacion, autoritet qeveritar apo publik, përfshinë çdo administrues, pranues, të deleguar, ose përfaqësues të ngjashëm të subjektit në fjalë;
- 1.24. **SPR** - Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara të ONAC-ut;
- 1.25. **Avion Shtetëror** - çdo avion i cili shfrytëzohet vetëm për shërbime ushtarake, doganore, dhe policore. Nuk përfshin ndonjë avion në pronësi të Qeverisë të cilët angazhohen në operime që përmbushin kriteret e definicionit të transportit ajror komercial;

1.26. **Shërbimet e vëzhgimit** - nënkupton ato pajisje dhe shërbime të cilat përdoren për përcaktimin e pozicionit të avionëve në mënyrë që të mundësohet ndarje e sigurt e trafikut;

1.27. **Tarifat e shfrytëzimit** - tarifa të cilat i zbaton ASHNA për pronarët dhe operatorët e avionëve lidhur me ofrimin e shërbimit të navigacionit ajror të cekura në këtë ligj;

1.28. **RFV** - Rregullat e Fluturimit Vizual;

1.29. **Ministria** - ministria përkatëse për aviacionin civil.

Neni 4

Rregullat dhe Standardet e Aviacionit Civil në Republikën e Kosovës

1. Aktivitetet e aviacionit civil në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës kryhen në përputhje me dispozitat e Ligjit ne fuqi mbi Aviacionin Civil, Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, te datës 07 dhjetor 1944 dhe Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

2. Çdo dispozitë ligjore, drejtpërdrejt e aplikueshme, e dalur nga Marrëveshja për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit do të mbizotëroj cilëndo dispozitë apo aspekt ligjor të Republikës së Kosovës që nuk është në përputhje me të.

Neni 5

Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia për Shërbimet e navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës ("AShNA") e cila është e përkushtuar për operimin e sigurt të sistemit të navigimit ajror të Republikës së Kosovës.

2. ASHNA do të veprojë në pajtim me politikën, legjisllacionin, standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për aviacionin civil në Republikën e Kosovës si dhe në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara të ONAC mbi shërbimet e navigimit ajror. AAC mund të nxjerrë procedura apo rregulla shtesë.

3. ASHNA është organizatë e pavarur buxhetore dhe autoritet publik me buxhet të vetin që administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me legjisllacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

4. ASHNA funksionon dhe organizohet e ndarë prej AAC-së.

5. ASHNA ka kapacitet të plotë juridik dhe vepron si një ofrues i shërbimeve jo-fitimprurës, i cili mbulon shpenzimet dhe bazohet në performancë.

6. ASHNA drejtohet nga Drejtori i punësuar me orar të plotë i cili do të jetë autoriteti përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe për vendim-marrje.

7. Drejtori ndihmohet nga Zëvendës Drejtorët të punësuar me orar të plotë.

8. ASHNA vepron në interes publik dhe në mënyrë të pavarur ushtron kompetencat dhe detyrat e parapara me këtë Ligj dhe me akte nënligjore

9. Drejtori i përgjigjet dhe i raporton Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 6

Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të ASHNA

1. Një person mund të emërohet drejtor i ASHNA, nëse ai/ajo përmbush kushtet në vijim:

1.1. të këtë diplomë universitare nga një institucion i akredituar akademik, apo një gradë pasuniversitare në fushën e aviacionit civil;

1.2. të këtë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në menaxhim në fushën e Aviacionit civil apo navigacionit ajror;

1.3. të mos këtë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;

1.4. të mos këtë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë monetar, financiar ose interes tjetër në ndonjë organizatë biznesore që është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil;

2. Drejtorin e emëron Qeveria pas dorëzimit të rekomandimit nga Ministri. Ministri, para rekomandimit, formon një Komision vlerësues, i cili është përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve, që përmes një konkursi të hapur ka për qëllim të sigurojë emërim të bazuar në merita dhe kualifikimin, që përmbush kushtet e kërkuara sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Me propozim të Ministrit, Qeveria më akt nënligjor cakton formën e kompensimit dhe përfitimet tjera të cilat i paguhen Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorëve. Me rastin e caktimit të kompensimit të Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorëve, Ministri duhet të këtë në konsideratë rëndësinë e pozitës së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorëve për ushtrimin e mirë dhe të sigurt të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës.

4. Drejtori do të shërbejë me orar të plotë, për një periudhë pesë (5) vjeçare. Me rekomandimin e Ministrit dhe miratimin e Qeverisë, pas skadimit të mandatit fillestar, ai mund të rëmërohet.

5. Me propozim të Ministrit, Qeveria mund të shkarkojë drejtorin vetëm atëherë kur:

5.1. ka bërë shkelje të ligjit dhe shkelje të rëndë të detyrave profesionale të tij/saj;

5.2. është dënuar për një vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm;

5.3. përvetëson në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mjete monetare-financiare ose interes tjetër në ndonjë organizatë biznesore, të angazhuar në sektorin e aviacionit civil;

5.4. bëhet i/e pa aftë të kryej detyrat e tij/saj për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj rresht, ose

5.5. angazhohet në ndonjë biznes profesion apo punë tjetër.

6. Nëse Drejtori beson se është larguar në mënyrë të paligjshme ai/ajo rastin mund t'ia drejtojë gjykatës kompetente.

Neni 7

Kompetencat e Drejtorit të ASHNA

1. Drejtori prioritet të madh i kushton ruajtjes së sigurisë të navigacionit ajror dhe siguron ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisë të ASHNA-s në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Drejtori mbikëqyr të gjitha çështjet e sigurisë, teknike operative, administrative, financiare dhe ligjore, të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me menaxhimin dhe operimin e ASHNA-s dhe me pronat e saj.

3. Drejtori përfaqëson ASHNA-n në projektet dhe iniciativat vendore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me aktivitetet e saj.

4. Drejtori siguron që aktivitetet e ASHNA-s të jenë në përputhje me të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike si dhe Përgjegjësitë dhe me ligjet tjera relevante.

Neni 8

Zëvendësdrejtorët e ASHNA

1. Drejtori ndihmohet nga dy profesionist me kualifikime të cilët shërbejnë në cilësinë e Zëvendësdrejtorëve si:

1.1. Zëvendësdrejtori për shërbime operative;

1.2. Zëvendësdrejtor për shërbime administrative financiare;

2. Zëvendësdrejtorët për punën e tyre i raportojnë Drejtorit të ASHNA-së.

3. Kompetencat, përgjegjësitë, kriteret dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e zëvendësdrejtorëve behët përmes aktit nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria.

Neni 9 Personeli i ASHNA

Drejtori me akt nënligjor rregullon funksionimin dhe pozitat e personelit.

Neni 10 Delegimi i Detyrave

1. Drejtori mundet që me shkrim t'ia delegojë detyrat dhe kompetencat e veta ndonjërit prej personelit vartës të tij por me kusht që Drejtori të mbetet përgjegjës për të siguruar që vartësi të ushtrojë në mënyrë të ligjshme çdo detyrë ose kompetencë të deleguar.

2. Drejtori nëse e vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme për të arritur kryerjen e duhur të funksioneve që i janë dhënë ASHNA-s me këtë ligj mund të angazhojë kontraktues të kualifikuar për kryerjen e funksioneve të tilla. Zgjedhja e kontraktuesve të tillë bëhet në procesin konkurrues të prokurimit, në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Neni 11 Të hyrat e ASHNA

1. Të hyrat e ASHNA-s do të përbëhen nga:

1.1. Tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA; dhe

1.2. Donacionet, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për ASHNA-në;

2. Për çdo vit fiskal Drejtori përgatit propozim-kërkesën për buxhet dhe alokime për ASHNA-në dhe i dorëzon Ministrit përkatës të Financave. Përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve të tilla e bënë në pajtim me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke marr parasysh nivelin e shpenzimeve aktuale dhe të parashikuara si dhe të hyrave të dedikuara të ASHNA-s.

Neni 12 Kontestet Administrative

Përveç nëse kontesti ka të bëjë me një shkelje të dyshuar të Ligjit të Prokurimit Publik, çdo person i cili ka një interes të veçantë dhe është i/e dëmtuar nga ndonjë veprim procedural, përmbajtjesor, lëshim të Drejtorit ose të personelit ASHNA-s dhe i cili beson se një veprim ose lëshim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose me legjislacionin në fuqi mund ta kontestojë veprimin ose lëshimin e tillë në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm të Procedurës Administrative.

Neni 13 Ndarja e Kompetencave

1. AAC-ja është autoriteti kompetent i përfaqësimit të Republikës së Kosovës në çështjet e navigacionit ajror lidhur me shprehjen e interesave sovrane dhe zotimeve të tjera në nivel shtetëror.

2. ASHNA është e autorizuar për të menaxhuar marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare dhe ofruesit tjerë të shërbimeve për të gjitha çështjet operative dhe teknike.

Neni 14 **Rregullimi dhe Mbikëqyrja e ASHNA-s**

1. ASHNA duhet të posedojë një certifikatë të lëshuar nga AAC-ja për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror brenda Republikës së Kosovës.
2. ASHNA përgjigjet dhe jep llogari para AAC-së për çështjet e parapara me Ligjin e Aviacionit Civil.
3. Përveç nëse specifikohet ndryshe nga AAC-ja, ASHNA duhet të veprojë në përputhje me Standardet dhe Praktikatat e Rekomanduara të ONAC-ut lidhur me shërbimet e navigacionit ajror.

Neni 15 **Përcaktimi dhe Fushëveprimi Gjeografik**

1. ASHNA duhet të koordinojë dhe bashkëpunojë me shërbimet dhe njësitë adekuate të NATO-s, shërbimet, njësitë tjera kombëtare dhe ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar zbatimin e marrëveshjeve me shkrim midis ASHNA-s dhe autoriteteve të NATO-s ose të marrëveshjeve ekuivalente ligjore lidhur me menaxhimin e blloqeve specifike të hapësirës ajrore.
2. Asgjë nga ky ligj nuk e ndalon që në të ardhmen të zhvillohen dhe zbatohen shfrytëzime fleksibile të hapësirës ajrore dhe procedura për menaxhimin e hapësirës ajrore së bashku me autoritetin përkatës të NATO-s që merret me shërbimin e navigacionit ajror.

Neni 16 **Autorizimet dhe Përgjegjësitë e ASHNA**

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me kontratë ose marrëveshje ndërkombëtare ASHNA do të jetë përgjegjëse për:
 - 1.1. ofrimin e Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror;
 - 1.2. menaxhimin e Qarkullimit të Trafikut Ajror dhe të Hapësirës Ajrore (në bashkëpunim me NATO-n);
 - 1.3. shërbimet e Informimit Aeronautik;
 - 1.4. shërbimin Meteorologjik Aeronautik;
 - 1.5. blerjen, instalimin, mirëmbajtjen, operimin dhe modernizimin e komunikimit, navigacionit, paisjeve dhe sistemeve të vëzhgimit të hapësirës ajrore;
 - 1.6. prokurimin, instalimin, mirëmbajtjen, operimin, dhe modernizimin e të gjitha pajisjeve përcjellëse të nevojshme të navigacionit (me përjashtim të paisjeve ndihmëse vizuale) dhe furnizuesve primarë dhe të përsëritshëm të energjisë dhe furnizuesve ndihmës. ASHNA dhe operatorët e aeroportit ose kompanitë të cilat menaxhojnë dhe operojnë aeroportet në Republikën e Kosovës do ta kenë Memorandumin e Mirëkuptimit ku deklarohet pronësia, përgjegjësia, mirëmbajtja dhe operimi për paisjet e tilla. Memorandumi i Mirëkuptimit do të rishikohet çdo vit me qëllim të sigurimit të relevancës dhe efektivitetit konstant;
 - 1.7. ofrimin e trajnimeve dhe këshillave në lidhje me navigacionin ajror;
 - 1.8. realizimin e hulumtimeve dhe zhvillimeve në lidhje me navigacionin ajror;
 - 1.9. zhvillimin e metodave për shpejtimin e modernizimit të kontrollit të trafikut ajror dhe përmirësimin e sigurisë së aviacionit lidhur me kontrollin e trafikut ajror;
 - 1.10. marrëveshjet për zhvillim me Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së dhe me shfrytëzuesit të produkteve, shërbimeve dhe kapaciteteve të cilat i ofron;

1.11. veprimin në përputhje me standardet e të caktuara nga AAC-ja dhe të reagojë shpejt në gjetjet gjatë mbikëqyrjes nga AAC-ja;

1.12. konsultim me konsumatorët, udhëtarët përfshirë dhe me shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë siç janë kompanitë ajrore, transportuesit e ngarkesave, prodhuesit, aeroportet, aviacionin e përgjithshëm dhe të përqendrohet në realizimin e rezultateve që i plotësojnë nevojat e konsumatorëve të jashtëm të ASHNA;

1.13. konsultimin dhe bashkëpunimin me operatorët ose kompanitë të cilat menaxhojnë dhe operojnë aeroportet në Republikën e Kosovës, me AAC-në, Ministrinë dhe NATO-n për të përcaktuar praktikatat më të mira për përmbushjen e nevojave të ndryshme në tërë hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës;

1.14. formulimin dhe rekomandimin tek AAC-ja për çdo ndryshim rregullativ të nevojshëm për ASHNA-n në mënyrë që të arrihen qëllimet e performancës dhe të ofrohet siguri në nivel të duhur;

1.15. ofrimin e këshillave për Qeverinë lidhur me zhvillimin e politikave të propozuara nga Qeveria për përdorimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës që të plotësojë nevojat e shfrytëzuesve duke pasur parasysh sigurinë kombëtare faktorët ekonomik, mjedisin dhe nevojën për një standard të lartë të sigurisë;

1.16. kryen e funksione tjera që kanë të bëjnë me aviacionin civil në Republikën e Kosovës të cilat i janë caktuar me këtë ligj ose me ndonjë akt tjetër normativ.

2. ASHNA koordinon përpjekjet e kërkimit dhe shpëtimit me Ministrinë përkatëse të Punëve të Brendshme dhe bashkëpunon ngushtë me Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

3. ASHNA do të sigurojë navigacion ajror të sigurt të vazhdueshëm të qetë dhe efektiv përmes kryerjes së detyrave si ofrues i shërbimit të navigacionit ajror përmes menaxhimit të hapësirës ajrore dhe përmes menaxhimit të qarkullimit të trafikut ajror në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil në fuqi dhe me Rregulloret në bazë të Marrëveshjes për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit.

Neni 17

Raportet me ofruesit tjerë të shërbimit

1. ASHNA është e autorizuar për të negociuar marrëveshje kontraktuale me ofruesit tjerë të shërbimit për navigacion ajror të cilët janë çertifikuar në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit për t'i mundësuar ASHNA-s shërbim nga të tjerët në për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në Qiellin e Vetëm Evropian. Marrëveshja e tillë do t'i nënshtrohet miratimit nga AAC-ja, siç është përcaktuar me legjislacionin përkatës.

2. Në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve shërbimet e navigacionit ajror të ofruara nga ASHNA mund të:

2.1. shtrihen në hapësirën ajrore përtej kufijve të Republikës së Kosovës; dhe

2.2. kryhen me ndihmën e ofruesve të shërbimit të navigacionit të shteteve tjera.

Neni 18

Transparenca e llogarive

1. ASHNA mban llogari transparente dhe do të publikojë në raport vjetor dhe ueb faqe të saj, që i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në përputhje me Ligjin.

2. ASHNA dorëzon Raportin Vjetor të punës për miratim në Qeveri.

Neni 19

Pronësia e Infrastrukturës së ASHNA-s

1. Infrastruktura e ASHNA-s do të jetë në pronësi të ASHNA-s.

2. Shpenzimet lidhur me vendosjen zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës do të mbulohen nga të hyrat e dedikuara për ASHNA ose përmes përkrahjeve tjera ekonomike nga Qeveria për çështje urgjente

3. Objektet dhe paisjet e operuara nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"- Kontrolli Ajror dhe të cilat shfrytëzohen për shërbimet e navigacionit ajror do të kalojnë në autoritetin dhe përgjegjësinë e ASHNA-së që nga momenti i themelimit.

Neni 20 **Tarifat e Shfrytëzimit**

1. Tarifat e shfrytëzimit të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA do të përfshijnë:

1.1. Tarifat e afrimit të vlerësuara për ofrimin e shërbimit të navigacionit ajror brenda hapësirës ajrore të Kosovës; dhe

1.2. Tarifat e mbiflurimit të vlerësuara për avionët që janë të autorizuar për ta shfrytëzuar hapësirën ajrore të Kosovës.

2. ASHNA do të lejohet vetëm për të vlerësuar dhe mbledhur Tarifat e Afrimit dhe Tarifat e mbiflurimit, kurse rregullimin e tarifave të tilla e bën AAC-ja në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil.

3. ASHNA propozon tarifat e shfrytëzimit për shërbimet e ofruara të navigacionit ajror në mënyrë që tarifat të jenë sa më konkurruese me tarifat e ngjashme të vendosura nga vendet e tjera në Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe të llogaritura mbi bazën e kthimit të arsyeshëm të shpenzimeve duke marrë parasysh tërë burimet e tjera të të hyrave.

4. AAC shqyrton dhe miraton tarifat e propozuara nga ASHNA në pajtim me Ligjin për Aviacionin Civil dhe informon Ministrinë për caktimin e tarifave.

5. Tarifat e shfrytëzimit janë obligative për operatorin e avionit. Në qoftë se operatori i avionit është i panjohur detyrimi për pagesën e tarifës së shfrytëzimit bie mbi pronarin e avionit.

6. Regjimi i tarifave të shfrytëzimit do të përcaktohet me legjislacion për krijimin e një skeme të përbashkët tarifore për shërbimet e navigacionit ajror dhe me ndryshimet/plotësimet e saj. Normat e përcaktuara në këtë mënyrë sigurojnë që të mos ketë diskriminime në mes të shfrytëzuesve të ndryshëm.

7. ASHNA mund t'ia refuzojë ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror një shfrytëzuesi të hapësirës ajrore i cili shkel kushtet e pagesës përveç rasteve emergjente të aterimit

Neni 21 **Fluturimet e liruara nga tarifat e shfrytëzimit**

1. Fluturimet me Rregulla Vizuale të Fluturimit dhe avionët e shfrytëzuar nga Shteti siç janë ata ushtarakë, doganorë dhe të shërbimit policorë duhet të lirohen nga tarifat e shfrytëzimit.

2. Shteti duhet të sigurojë që ASHNA të kompenzohet për fluturimet të cilat vendoset të lirohen nga pagesa e tarifave.

Neni 22 **Aspektet e punësimit dhe ato sociale**

ASHNA siguron kontinuitetin e ofrimin të shërbimeve të navigacionit ajror në çdo kohë. Çfarëdo veprimi i personelit të ASHNA, siç janë grevat dhe praktikat e ngjashme që mund të rrezikojnë jetën, sigurinë personale apo shëndetin e personave është i ndaluar.

Neni 23 **Transferimi i ofrimit të shërbimeve**

Me hyrjen e këtij ligji në fuqi, ASHNA të gjithë shfrytëzuesve do t'u ofrojë shërbimet e navigacionit ajror civil të cilat deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji i ofronte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"- Kontrolli Ajror.

Neni 24 **Shfuqizimi i legjislacionit të mëparshëm inkompatibil**

1. Përveç aty ku është përcaktuar ndryshe, ky ligj shfuqizon të gjitha aktet normative që nuk janë në përputhshmëri me të.
2. Për aty sa janë në përputhshmëri me këtë ligj të gjitha aktet normative të cilat trajtojnë çështjet brenda fushëveprimit të këtij ligji do të konsiderohen si rregullore për zbatim të lëshuara nën autoritetin e këtij ligji. Aktet e tilla nënligjore do të vazhdojnë të mbesin në fuqi derisa të mos zëvendësohen me rregullore për zbatim të cilat e mbulojnë fushën e njëjtë.

Neni 25 **Dispozitat kalimtare**

1. Drejtori i ASHNA emërohet nga Qeveria brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në pajtueshmëri me procedurat dhe kërkesat të përcaktuara më këtë ligj.
2. Për zbatimin e këtij Ligji, Qeveria, AAC dhe ASHNA, në bazë të kompetencave të veta, në afatin prej gjashtë (6) muajsh nxjerrin aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.
3. Tërë personeli profesional dhe administrativ i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"-Kontrolli Ajror transferohet në ASHNA.
4. Në rast se ky ligj apo ndryshim dhe plotësim i këtij ligji, interpretohet në papajtueshmëri me Ligjin për Aviacionin Civil, ky i fundit do të mbizotërojë.
5. Hyrja në fuqi këtij ligji nuk i heq autoritetin e dhënë Organizatës Veri-Atlantike (NATO) në lidhje me hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-250
20 mars 2014

Shpallur me dekretin Nr. DL-010-2014, datë 07.04.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga